



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM ELBASAN

Website: www.gjykata.gov.al

Adresa :Lagjia "5 Maji", Rruga "Koço Brisku". Elbasan,Shqipëri.

PRGRAMI TRANSPARENCËS

ANEKS B. Indeks- Lidhja (6)

MËNYRAT E PARAQITJES SË ANKIMIT NË GJYKATËN E SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM ELBASAN

I. Hyrje

Ankimi është mjet ligjor (procedural) që i mundëson kërkuarit të parashtojnë ankesën e tij. E drejta e ankimit konsiderohet si garanci për të drejtat e kërkuarit, por këtu i referohemi ankimit në lidhje me të drejtën për informim që rregullohet me të Ligj Nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit" i ndryshuar¹ dhe lidhet me parregullësi të hasura si psh.: vonesa në kthim përgjigje, konstatime të sjelljeve të papërshtatëshme të nëpunësve,vonesa në gjykime, vonesa në vendimmarrje dhe çdo shqetësimi i kërkuarve që lidhet me Gjykatën dhe jo ankimit si mjet ligjor (procedural) që u mundëson palëve në proces që të parashtojnë kundërshtimet e tyre ndaj vendimeve të gjykatës në mënyrë që një gjykatë më e lartë të vlerësojë nëse kundërshtimi i tyre është apo jo i bazuar në ligj.

Të gjitha ankesat trajtohen, si rregull, nëpërmjet konsultimit pa pagesë duke paraqitur ankesën tuaj nëpërmjet postës, postës elektronike manjola.kume@gjykata.gov.al , si edhe pranë Zyrës së Protokollit të kësaj Gjykate që gjendet pranë Zyrës së Arkivës së Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

Ankesat trajtohen brenda afateve ligjore që parashikohen edhe për të drejtën për informim².

II. Afati për marrjen e përgjigjes mbi ankimin

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan trajton ankesën në zbatim të Ligj Nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit" i përditësuar, duke mundësuar qartësimin e situatës dhe duke

¹ (I ndryshuar me ligjin nr.78, datë 21.09.2023 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit") (i përditësuar).

² Ligj Nr.119/2014 "Për të drejtën e Informimit" i ndryshuar, -Neni 15.

dhënë zgjidhje të problematikave në përputhje me bayën ligjore me po të njëjtat afate si kërkesa për informacion por jo më vonë se 10 ditë pune nga dita e dorëzimit të saj.³

III. Kujt mund t'i drejtoheni?

Në ankimin tuaj ju mund t'i drejtoheni Kryetarit të Gjykatës, Kancelarit dhe Koordinatorit për të drejtën e informimit. Përgjigja mbi ankimin do të trajtohet referuar nenit 15 të Ligj Nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit" i ndryshuar.

Neni 15

Afati për marrjen e informacionit

1. Autoriteti publik trajton kërkesën për informim, duke parashtruar informacionin e kërkuar sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se 10 ditë pune nga dita e dorëzimit të saj, përveç rasteve kur ligji i posaçëm parashikon ndryshe. 2. Kur autoriteti publik që merr kërkesën për informim ia dërgon atë një autoriteti tjetër, ai kthen përgjigje jo më vonë se 15 ditë pune nga dita e mbërritjes së kërkesës në autoritetin e parë. 3. Afati i parashikuar në pikat 1 dhe 2, të këtij neni, mund të zgjatet me jo më shumë se 5 ditë pune për një nga shkaqet e mëposhtme: a) nevoja për të kërkuar dhe shqyrtuar dokumente të shumta e voluminoze; b) nevoja për t'i shtrirë kërkimet në zyra dhe mjedise që janë fizikisht të ndara nga zyra qendrore e autoritetit; c) nevoja për t'u konsultuar me autoritete të tjera publike përpara marrjes së një vendimi për plotësimin ose jo të kërkesës. Vendimi për zgjatjen e afatit i njoftohet menjëherë kërkuarit. 4. Në çdo rast, mostrajtimi i kërkesës për informim brenda afateve të sipërpërmendura do të konsiderohet refuzim. 5. Dispozitat e këtij neni zbatohen edhe për njohjen me informacionin arkivor të çdo lloji.

IV. Si mund të drejtoheni?

Ju mund t'i drejtoheni gjykatës duke plotësuar formularin e ankesës i cili gjendet i publikuar në faqen zyrtare rubrika Programi i Transpaencës, ose duke e plotësuar këtë formular në ambientet e gjykatës në Zyrën e Koordinatorit për të Drejtën e Informimit në rubrikat si në vijim:

³ Ligj Nr.119/2014 "Për të drejtën e Informimit" i ndryshuar, -Neni 15.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM ELBASAN

Website: www.gjykata.gov.al

Adresa :Lagjja "5 Maji", Rruga "Koço Brisku", Elbasan,Shqipëri

FORMULAR ANKESE

Në bazë të Ligjit Nr. 119/2014 "Për të Drejtën e Informimit"

Emri / Mbiemri¹ :
Adresa:
Qyteti :
Telefon:
E-mail:

Autoriteti Publik :
Adresa:
Qyteti:

Identifikoni saktë Autoritetin Publik/Institucionin ndaj të cilit ankoheni.

Përshkruani çdo veprim të pretenduar si shkelje nga Autoriteti Publik dhe nëse dispononi dokumente bashkëlidhni ato.Përshkruani çfarë kërkoni nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në përputhje me nenin 24 të ligjit nr.119/2014.

(Data) _____

(Firma) _____

Formulari i ankesës duhet të shoqërohet me formularin e kërkesës për informim drejtuar Autoritetit publik si dhe recetën postare ose emailin drejtuar Autoritetit Publik.

Informacioni në këtë format dhe të dhënat e ID do të përpunohen në përputhje me ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Për sqarime më të detajuara kontaktoni KDIMDP ose koordinatorin e të drejtës për informim.

¹ Në rastet kur informacioni i kërkuar përmban të dhëna personale, kërkohet dokumenti i identifikimit të kërkuarit dhe/ose prokura e përfaqësuesit ligjor.

Shënim: Ky formular miratohet me rishikimin e Programit të Transparencës dhe i shtohet listës së formularëve në këtë program. (bashkëlishur).

- Ju mund t'i drejtoheni gjykatës duke dërguar ankimin tuaj në postën elektronike manjola.kume@gjykata.gov.al
- Ju gjithashtu mund të drejtoni ankesën tuaj referuar nëpunësit civil gjyqësor duke plotësuar formularin i cili gjendet në këtë lidhje:

<https://gjykata.gov.al/media/4874/formulari-tip-i-ankes%C3%ABs-p%C3%ABr-n%C3%ABpun%C3%ABsin-civil-gjyq%C3%ABsor.pdf>

Faleminderit,

Miratoi
**ZV/KRYETAR
Z. ELIS DINE**
**GJYKATA E SHKALLËS SË PARË
E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM ELBASAN**

